

## RAPORT MONITORIMI JANAR–GUSHT 2022

### DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP), është tërësia e institucioneve administrative dhe ofruese të shërbimeve arsimore parauniversitare, pjesë integrale e sistemit të ministrisë përgjegjëse për arsimin, që kontribuon në realizimin e qëllimit të përgjithshëm për të siguruar shërbim arsimor cilësor.

DPAP-ja ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në:

- *nivel qëndror*, nëpërmjet drejtorisë qendrore, DPAP.
- *nivel rajonal*, nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar, DRAP.
- njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë *zyrat vendore të arsimit parauniversitar, ZVAP*.
- *institucionet arsimore* të sistemit parauniversitar publik, shkollat.

#### **Misioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.**

*Misioni i DPAP-së është ofrimi dhe sigurimi i shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me politikën, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit parauniversitar, me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësit, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes.*

**Përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.**

- ✚ Ofrimin e një shërbimi cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.
- ✚ Organizimin e punës për menazhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- ✚ Koordinimin e administrimit të burimeve njerëzore në sistemin arsimor parauniversitar publik, sipas legjislacionit në fuqi.
- ✚ Sigurimin se funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar për institucionet publike të arsimit parauniversitar të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- ✚ Vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të licensimit dhe të ushtrimit të veprimtarisë së institucioneve arsimore private në fushën e arsimit parauniversitar, si dhe t'i propozojë ministrit dënimin administrativ plotësues të pezullimit apo heqjes së licencës për ushtrimin e veprimtarisë.
- ✚ Vlerësimin nëpërmjet DRAP-ve dhe ZVAP-ve, kërkesat e ministrisë përgjegjëse për arsimin si dhe të shqyrtojë për përmbushjen e kriterëve infrastrukturore për hapjen e institucioneve arsimore dhe ushtrimin e veprimtarisë në fushën e arsimit parauniversitar.

**Detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.**

- ✚ Bashkërendon zbatimin e politikave, strategjive të zhvillimit, programeve, projekteve, kuadrin rregullator dhe kurrikulën në fushën e arsimit parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.
- ✚ Siguron, në bashkëpunim me drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar, inspektimin dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimit dhe të sistemit arsimor parauniversitar.
- ✚ Analizon dhe përcakton kostot e realizimit të shërbimeve arsimore, duke mbledhur e përpunuar të dhëna nga drejtoritë rajonale, zyrat vendore dhe institucionet arsimore.
- ✚ Mbështet institucionin përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar (ASCAP) për zbatimin e dokumenteve kurrikulare, për zhvillimin profesional, për organizimin e kualifikimit të punonjësve arsimorë dhe për mbledhjen e të dhënave statistikore në sistemin e arsimit parauniversitar.
- ✚ Në përputhje me analizat e kryera, planifikon organizimin dhe shtrirjen e shërbimit arsimor, programon punën, siguron dhe optimizon burimet për ofrimin e shërbimeve arsimore parauniversitare, si dhe planifikon buxhetin në terma afatshkurtër e afatmesëm për institucionet publike të arsimit të parauniversitar.

- ✚ Siguron mbledhjen, plotësimin, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore për institucionet arsimore, sipas udhëzimeve të ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- ✚ Mbështet ministrinë dhe institucionin përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar me të dhëna, ekspertizë teknike dhe propozime në hartimin e politikave të zhvillimit në fushën e arsimit parauniversitar, duke marrë parasysh veçoritë demografike, të terrenit, të zhvillimit ekonomik e të infrastrukturës vendore.
- ✚ Organizon dhe monitoron në bashkëpunim me drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar procesin e përzgjedhjes, si dhe shpërndarjen dhe pajisjen e insitucioneve arsimore me tekste shkollorë dhe raporton në MASR për monitorimin e kryer.
- ✚ Siguron koordinimin e veprimtarive të drejtorive rajonale dhe zyrave vendore të arsimit parauniversitar.
- ✚ Koordinon administrimin e burimeve njerëzore në sistemin arsimor parauniversitar publik, sipas legjislacionit në fuqi.
- ✚ Drejton dhe mbikqyr procedurat e punësimit të mësuesve në isntitucionet e arsimit parauniversitar nëpërmjet Portalit “Mësues për Shqipërinë”.

### **Objektivat e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.**

- ✓ Të drejtojë dhe mbikëqyr procedurat e punësimit të mësuesve në institucionet e arsimit parauniversitar nëpërmjet Portalit “Mësues për Shqipërinë”;
- ✓ Të ndjekë procedurat për emërimin dhe shkarkimin e drejtuesve, mësuesve dhe personelit të institucioneve arsimore;
- ✓ Të verifikojë zbatimin e ligjshmërisë për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve në klasë;
- ✓ Të verifikojë regjistrimet e nxënësve, në ZVAP-et dhe institucionet arsimore publike dhe private;
- ✓ Të vlerësojë procesin e hartimit të planit afatmesëm dhe planit vjetor;
- ✓ Të vlerësojë planifikimin vjetor lëndor dhe planifikimin lëndor të periudhës bazuar në kurrikulën me kompetenca;
- ✓ Të monitorojë procesin e shpërndarjes së teksteve shkollorë në ZVAP-et dhe institucionet arsimore publike;
- ✓ Të monitorojë procesin e provimeve kombëtare në arsimin parauniversitar, sesioni i parë dhe i dytë;
- ✓ Të koordinojë dhe monitorojë procesin e vlerësimit të arritjeve në arsimin fillor;
- ✓ Të evidentojë fëmijët romë dhe egjyptianë dhe të monitorojë veprimtarinë i IA për këtë komunitet nxënësish.
- ✓ Të monitorojë zbatimin e masave anti COVID-19 nga IA-të dhe zbatimin e udhëzimit të fillim vitit shkollor.

- ✓ Të vlerësojë procesin e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë dhe mësuesve ndihmës;
- ✓ Të koordinojë dhe monitorojë zhvillimin e rrjeteve profesionale në nivel ZVAP-i;
- ✓ Të vlerësojë rolin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet arsimore;
- ✓ Të vlerësojë procesin e hartimit të Kartës së Performancës së shkollës në ZVAP-et dhe institucionet arsimore publike dhe private;
- ✓ Të vlerësojë cilësinë e drejtimit dhe menaxhimit të IA-së. (fusha e I, vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i shkollës);
- ✓ Të vlerësojë cilësinë e ofruar nga IA-ja për mirëqenien dhe sjelljen e nxënësve. (fusha IV, vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i shkollës)
- ✓ Të vlerësojë procesin e zhvillimit të praktikave profesionale dhe të mentorimit të tyre.
- ✓ Të menazhojë institucionin përmes planifikimit, monitorimit, raportimit me anë të planeve mujore, individuale, sektoriale dhe në nivel drejtorie;
- ✓ Të informojë grupet e interesit me anë të raporteve të inspektimit, të raportit vjetor, si dhe të faqes së internetit, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- ✓ Të analizojë gjetjet nga inspektimet dhe monitorimet, të cilat do të shoqërohen me rekomandime për përmirësim dhe të bëjë sugjerime për ndryshime të nevojshme në bazën ligjore;
- ✓ Të mirëmbajë faqen online të institucionit për përditësimin e informacioneve;
- ✓ Të sigurojë se funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar për institucione publike të arsimit parauniversitar kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- ✓ Të vlerësojë përmbushjen e kriterëve të licensimit dhe të ushtrimit të veprimtarisë së institucioneve arsimore private në fushën e arsimit parauniversitar;
- ✓ Të rakordojë me DRAP/ZVAP-et dhe institucionet arsimore publike për planifikimin dhe shpërndarjen e fondeve sipas parimit "Për nxënës";
- ✓ Të mbështetet ASCAP nga DPAP dhe DRAP-et në mbledhjen e të dhënave për të ndërtuar bazën qendrore e të integruar të të dhënave të sistemit të arsimit parauniversitar;
- ✓ Të vlerësohet nga DPAP dhe DRAP-et gjendja e mjedisit fizik/infrastruktura dhe mjaftueshmëria e burimeve, duke propozuar edhe masat e nevojshme;
- ✓ Të mbështetet ASCAP nga DPAP dhe DRAP-et në organizimin e procesit të identifikimit të nevojave për zhvillim profesional të të gjithë punonjësve të DRAP-ve dhe ZVAP-ve, specialistëve, drejtuesve, mësuesve etj;
- ✓ Të hartojë, sipas buxhetit të miratuar, planifikimin dhe zbatimin e planit financiar të prokurimit, konform akteve ligjore;
- ✓ Të menazhojë institucionin përmes planifikimit, monitorimit dhe raportimit me anë të planeve mujore, individuale, sektoriale dhe në nivel drejtorie;
- ✓ Të kryejë procedurat e prokurimit sipas procedurave ligjore dhe përdorimi i fondeve me efektivitet dhe efikasitet përgjatë vitit 2022;

- ✓ Të mirëmbajë faqen online të institucionit për përditësimin e informacioneve;
- ✓ Të zhvillojë ngritjen profesionale të stafit DPAP-së;
- ✓ Të përditësojë arshivën me aktet ligjore dhe nënligjore ne fuqi dhe ngritja e një archive elektronike;
- ✓ Të trajtojë ankesat e mundshme:
  - a) DPAP-ja do të zgjidhë ankesat në fushën e arsimit parauniversitar që vijnë nga nxënës, mësues, prindër dhe qytetarë;
  - b) DPAP-ja, në bashkëpunim me DRAP-et dhe ZVAP-et , do të verifikojë ankesat e ardhura nga MAS dhe institucione të tjera.

Tabela më poshtë paraqet strukturën organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar;




Figura 1. Struktura Organizative e DPAP




Figura 2. Struktura organizative e DPAP

Numri i miratuar i punonjësve në këto struktura është 509 punonjës, ndërsa numri faktik i punonjësve është 475 punonjës, nga të cilët 325 janë femra ose 68% e tyre.




Figura 3. Paraqitja grafike e numrit te punonjesve

## I. ADMINISTRIMI DHE MENAZHIMI I FONDEVE BUXHETORE

Monitorimi i zbatimit të buxhetit në periudhën Janar-Gusht 2022, për DPAP, përfaqëson vlerësimin e performancës së fondeve buxhetore nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ato të planifikuar, duke i krahasuar me treguesit e vitit të mëparshëm.

Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të DPAP-së, të detajuara në nivel kategorie shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar, duke mundësuar kështu sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menazhimit të buxhetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar menazhon fondet buxhetore të pagave, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative vetëm në programet buxhetore dhe për numrin e punonjësve si më poshtë:

### *Planifikim Menazhim (2022)*

Emërtimi	Punonjës të planifikuar	Punonjës fakt	Punonjës me kontratë
Numri	21	20	1

### *Praktikat e punës në administratën shtetërore*

Në zbatim të VKM n.395, datë 29.04.2015, “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucione të tjera publike”, të ndryshuar, si dhe në mbështetje të shkresës së MFE nr.277/1, datë 18.01.2022 “Detajimi i numrit të studentëve praktikantë për vitin 2022, në periudhën Janar 2022–Janar 2023, janë planifikuar 4 specialistë.

### A. Planifikim Menazhim

Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2022, DPAP ka vepruar në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menazhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, të ligjit nr.115/2021 “ Për Buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimit plotësues nr. 01 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”.

Për periudhën Janar-Gusht 2022 janë realizuar shpenzimet e fondeve buxhetore sipas planit të rishikuar buxhetor për çdo grup, titull, artikull.

## II. FONDET E MIRATUARA:

### A. Shpenzime Personeli

Fondet e miratuara për shpenzime personeli për vitin 2022 përfshijnë fondet e miratuara për pagat dhe sigurimet shoqërore. DPAP mbulon shpenzimet e personelit vetëm për punonjësit e drejtorisë qendrore.

#### **Pagat e punonjësve. Llogaria 600**

Fondi i miratuar nga buxheti i shtetit për vitin 2022 në zërin “paga” (600) është parashikuar dhe çelur në shumën 20,640,000 lekë. Realizimi për periudhën janar-gusht 2022 është në shumën 12,444,500 lekë ose 60% të planit vjetor.

- Referuar VKM-së nr.395, datë 29.04.2015, “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucione të tjera publike”, të ndryshuar, si dhe në mbështetje të shkresës së MAS nr.75/1, datë 07.02.2022 “ Për ndryshim në planin e buxhetit të vitit 2022”, fondi i miratuar për vitin 2022 për pagesën e praktikantëve është në shumën 2,500,000 lekë. Realizimi për periudhën janar-gusht 2022 është në shumën 1,488,639 lekë ose 60% të planit vjetor.

Për likuidimin e pagave të punonjësve është zbatuar Vendimi nr. 187, datë 8.3.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”; i ndryshuar, Vendimin nr. 202, datë 15.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendim nr.717, datë 23.6.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” i ndryshuar; Vendimi nr. 234, datë 20.04.2022 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”.

#### **Sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Llogaria 601**

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2022 në zërin; Sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601), është çelur në shumën 3,446,880 lekë. Realizimi për periudhën janar-gusht 2022 është në shumën 2,053,514 lekë ose 60% të planit vjetor.



Referuar VKM-së nr.395, datë 29.04.2015, “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucione të tjera publike”, të ndryshuar, si dhe në mbështetje të shkresës së MAS nr.75/1, datë 07.02.2022 “

Për ndryshim në planin e buxhetit të vitit 2022”, fondi i miratuar për vitin 2022 (Sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Llogaria 601) për pagesën e praktikantëve është në shumën 420,000 lekë. Realizimi për periudhën janar-gusht 2022 është në shumën 248,602 lekë ose 59% të planit vjetor. Për Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, Tatimin mbi të ardhurat është zbatuar Vendimi nr. 1025, datë 16.12.2020 të Këshilli të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale dhe maximale në shkallë vendi”, Vendimi nr. 158, datë 12.03.2022 të Këshilli të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe për periudhën janar–gusht 2022 janë likuiduar të gjitha detyrimet për sigurimet shoqërore dhe tatim taksat.

### **Shpenzime Operative**

Fondet e miratuara për shpenzime operative për vitin 2022 përfshijnë fondet e miratuara për blerjen e mallrave dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për funksionimin e institucionit, pa përfshirë shpenzimet për DRAP dhe ZVAP.

### **Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera. Llogaria 602**

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2022 në zërin mallra e shërbime të tjera (llogaria 602) është çelur në shumën 3,200,000 lekë dhe pas rishikimit të planit vjetor në zbatim të pikës 1, të VKM-së nr. 160, datë 14.03.2022 “Për reduktimin e shpenzimeve të transportit për funksionarët, nëpunësit, punonjësit e institucioneve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave dhe Shoqërive/ndërmarrjeve me kapital shtetëror”, ku është përcaktuar që të gjitha institucionet duhet të reduktojnë shpenzimet e transportit në masën 50% të planifikimit të bërë për vitin 2022”, plani i rishikuar për shpenzime operative për vitin 2022 është 2,600,000 lekë. Janë realizuar 1,562,818 lekë për periudhën janar-gusht 2022 ose 60 % të planit të periudhës vjetore.

Shpenzimet për këtë periudhë kryesisht janë fokusuar për mbulimin e shpenzimeve operative si drita, ujë, telefon, shërbim postar dhe udhëtim e dieta për punonjësit që janë dërguar me shërbim jashtë qendrës së punës në funksion të monitorimit të veprimtarisë së institucioneve arsimore publike dhe jopublike.

Nga prokurimet e parashikuara në fillim të vitit është realizuar vetëm prokurimi për karburantin, në muajin prill 2022.

### Vendimet gjyqësore

Gjatë periudhës është çelur fond për likuidimin e vendimeve gjyqësore në shumën 1,614,592 lekë dhe ky fond është përdorur për likuidimin e vendimit nr. 149 (914), datë 11.03.2021.

### Transferta për buxhetet familjare dhe individët. Llogaria 606

Për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2021 janë realizuar 147,000 lekë për shpërblimin e dy punonjësve që kanë dalë në pension. Për vitin 2022 nuk janë planifikuar fonde për buxhete familjare dhe individë, pasi nuk ka punonjës të institucionit që plotësojnë kushtet për pension pleqërie.

## B. Shpenzime për investime kapitale. Llogaria 231.

Plani i buxhetit për vitin 2022 në investime kapitale është zero lekë. DPAP mbulon vetëm shpenzimet për institucionin, prandaj dhe nuk ka fonde në këtë zë të buxhetit. Në bazë të planifikimit të buxhetit dhe të rregullores për funksionimin e DPAP, janë Drejtoritë Rajonale të Arimit Parauniversitar që menazhojnë fondet për shpenzime kapitale për institucionet e tyre dhe të varësisë. Paraqitja përmbledhëse e shpenzimeve të periudhës Janar-Gusht 2022 në DPAP, krahasuar me realizimin e vitit të kaluar dhe planin buxhetor paraqiten në shtojcat bashkëlidhur këtij raporti.

### **1. Mbi raportimin e detyrimeve të prapambetura të akumuluarra dhe krijuara rishtazi për vitin 2022.**

Në zbatim të ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, vendimit nr.50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, si dhe të udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014, të Ministrisë të Financave “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Shtojca 3, detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi dhe akumuluarra për vitin 2021 dhe për periudhën Janar-Gusht 2022 janë zero lekë.

***Për sa më sipër në periudhën Janar-Gusht 2022 në DPAP nuk është krijuar asnjë detyrim i ri dhe nuk ka detyrime të prapambetura nga vitet e kaluara.***

**2. Faktorët që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për vitin 2022:**

Baza ligjore për hartimin e kërkesave për financimin dhe realizimin e shërbimit arsimor publik, ku mbështeten kërkesat buxhetore për DPAP:

- *Neni 57 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.*
- *Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.*
- *Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.*
- *Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.*
- *Ligji nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022".*
- *Vendimit nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për arsimin 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj".*
- *Vendimi nr. 90, datë 17.2.2021 Këshillit të Ministrave "Për miratimin e programit të reformave ekonomike (erp) 2021–2023",*
- *Vendimi nr. 710, datë 1.12.2017 "Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022".*
- *Vendimi nr. 99, datë 27.2.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar".*
- *Vendimi nr. 465 datë 06.07.2022 "Për disa ndryshime në vendimin nr.175, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në arsimin parauniversitar", i ndryshuar".*
- *Vendimi nr. 187, datë 8.3.2017 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit", i ndryshuar.*
- *Vendimi nr. 234, datë 20.04.2022 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike".*
- *Vendimi nr. 158, datë 12.03.2022 të Këshilli të Ministrave "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".*
- *Vendimi nr. 77, datë 28.1.2015 të Këshillit të Ministrave "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor" i ndryshuar.*
- *Vendimi nr. 682, datë 29.7.2015 të Këshilli të Ministrave "Për përdorimin e fondeve buxhetore për transportimin e mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit", i ndryshuar.*

- *Vendimi nr. 870, datë 14.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” i ndryshuar.*
- *Vendimi nr. 185, datë 29.3.2018 i Këshillit të Ministrave “Për Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike”.*
- *VKM nr. 160, date 14.03.2022 “Për reduktimin e shpenzimeve të transportit për funksionarët, nëpunësit, punonjësit e insitucioneve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave dhe Shoqërive/ndërmarrjeve me kapital shtetëror”, ku është përcaktuar që të gjitha institucionet duhet të reduktojnë shpenzimet e transportit në masën 50% të planifikimit të bërë për vitin 2022”.*
- *Udhëzimi nr 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.*
- *Udhëzimi nr. 14, datë 24.03.2020 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat e menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit të buxhetit në gjendjene fatkeqësisë natyrore”.*
- *Udhëzimit nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” të ndryshuar*
- *Urdhrit Nr.31, datë 28.01.2020 të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e rregullores për funksionimin e insitucioneve arsimore parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,*
- *Urdhri nr. 135, datë 09.03.2020 i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për mbylljen e insitucioneve Arsimore për parandalimine përhapjes së Covid-19”;*
- *Rregullores Nr.4699/1 prot., datë 30.04.2019 të Ministritë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Rregullore për organizimin dhe funksionimit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”.*

## C. Të dhëna të përgjithshme

**C.1 Të dhëna mbi numrin e institucioneve arsimore për vitin shkollor 2020-2021 dhe 2021-2022**

Viti shkollor 2020-2021								
Kopshtet		Totali kopshte	Shkolla publike (drejtori me vete)		Totali shkolla publike	Shkolla private		Totali shkolla private
Publike	Private		9-vjecare +Mesme te Bashkuara	Gjinnaze + mesme të orientuara		9-vjecare	Mesme	
1907	249	2156	1057	346	1403	115	105	220
Viti shkollor 2021-2022								
Kopshte gjithsej		Totali kopshte	Shkolla Publike (drejtori më vete)		Totali shkolla publike	Shkolla Private		Totali shkolla private
Publik	Privat		9-vjecare +Mesme Bashkuara	Gjinnaze + mesme të orientuara te Veçanta		9-vjecare	Mesme	
1847	243	2090	1051	347	1398	115	105	220

**C.2 Numri i nxënësve për vitin shkollor 2021-2022**

Në Kopshte gjithsej		Total fëmijë në kopshte	Numri i nxënësve në Shkolla Publike (drejtori më vete)		Totali në shkolla publike	Numri i nxënësve në Shkolla Private		Totali në shkolla private
Publik	Privat		9-vjecare	Gjinnaze + mesme të orientuara te Veçanta		9-vjecare	Mesme	
62104	10280	72384	251207	73042	324249	26931	12146	39177

**C.3 Të dhëna për numrin e punonjësve mësimorë, për vitin shkollor 2020-2021; 2021-2022.**

Institucioni	AMU	AML	AMU	AML
	2020-2021	2020-2021	2021-2022	2021-2022
DRAP Durrës	8,754	2,491	8,769	2,499
DRAP Fier	4,692	1,281	4,698	1,267
DRAP Korçë	6,113	1,605	6,113	1,605
DRAP Lezhë	4,096	1,108	4,097	1,108
<b>Totali</b>	<b>23,655</b>	<b>6,485</b>	<b>23,677</b>	<b>6,479</b>

**C.4 Të dhëna për punësimet****Punësime nga Portali dhe me kandidatë jashtë Portalit për periudhën Janar-Gusht 2022**

DPAP, informohet në mënyrë periodike, nga Drejtoritë Rajonale, mbi punësimet e kryera në institucionet arsimore të varësisë. Bazuar në Udhëzimin Nr.12 datë 10.06.2021 të MASR “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e Portalit “Mësues për Shqipërinë”, Udhëzimin Nr.14 date 28.07.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 30 datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve në klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, ZVAP monitorojnë dhe dërgojnë informacion mbi punësimet nga portali “Mësues për Shqipërinë” me kontratë të përkohshme, me kontratë të përhershme, si edhe punësimet me kandidatë jashtë portalit. Referuar këtyre raportimeve, për periudhën janar-gusht 2022, situata është si më poshtë

<i>Punësimet Janar-Gusht 2022</i>				
DRAP	Punësime pa afat nga portali	Punësime me afat nga portali	Punësime me kandidatë jashtë portalit	Gjithsej punësime
Durrës	36	191	145	372
Fier	18	157	40	215
Korçë	21	145	33	199
Lezhë	13	110	65	188
<b>Totali</b>	<b>88</b>	<b>603</b>	<b>283</b>	<b>974</b>

## Punësimet sipas profileve:

Nr	Profili	Punësime vende vakante	Punësime provizore nga portali	Punësime me kandidate jashte portalit	Gjithsej punësime
1	Arsimi Fillor	20	107	103	231
2	Arsimi Parashkollor	1	4	0	5
3	Arsimi Special	4	73	15	91
4	Art Pamor	0	2	3	5
5	Art pamor (shkolla artistike)	0	2	0	2
6	Balet (shkolla artistike)	0	2	0	2
7	Biologji	4	35	17	56
8	Edukim Fizik	20	38	24	82
9	Fizikë	2	9	4	15
10	Gjeografi	2	27	3	32
11	Gjuhë Angleze	6	66	24	96
12	Gjuhë Frënge	6	12	6	24
13	Gjuhë Gjermane	0	3	1	4
14	Gjuhë Greke	1	0	5	6
15	Gjuhë Italiane	2	6	5	13
16	Gjuhë Maqedonëse	0	0	0	0
17	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	5	90	18	113
18	Histori	1	39	9	49
19	Kimi	2	11	1	14
20	Matematikë	6	54	29	89
21	Muzikë	2	4	9	15
22	Muzikë (shkolla artistike)	3	4	0	7
23	Shkenca Sociale	1	9	1	11
24	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	0	6	6	12
	<b>TOTALI DPAP</b>	<b>88</b>	<b>603</b>	<b>283</b>	<b>974</b>

## Portali “Mësues për Shqipërinë” 2022:

Në zbatim të Udhëzimit të MAS, Nr.12, datë 10.06.2021, “Për procedurat e pranimit dhe të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike, të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e Portalit “Mësues për Shqipërinë”, të ndryshuar, dhe shkresës së MAS Nr. 1567/1 datë 05.04.2022, “Për një ndryshim të afateve për procedurat e konkurrimit të mësuesve në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2022, u realizua Portali “Mësues për Shqipërinë”2022, për kandidatët të cilët dëshirojnë të ushtrojnë profesionin e mësuesit.

- I. Numri i aplikimeve dhe i kandidatëve sipas zyrave arsimore në Portalin “Mësues për Shqipërinë”, për vitin 2022-2023 paraqitet si më poshtë:

Nr.	DRAP	Numri i kandidateve	Numri i aplikimeve
1	Durrës	4216	10183
2	Fier	2281	4973
3	Korçë	2889	7016
4	Lezhë	1008	2267
<b>Totali</b>		<b>10394</b>	<b>24439</b>

Sipas lëndëve që kanë aplikuar dhe referuar ndarjes sipas 4 drejtorive rajonale, situata paraqitet si në tabelën më poshtë:

Nr.	Profilet	DRAP Durrës	DRAP Fier	DRAP Korçë	DRAP Lezhë	Numri i kandidatëve
1	Arsimi Fillor	506	388	454	133	1481
2	Arsimi Parashkollor	279	251	316	108	954
3	Arsimi Special	77	76	29	6	188
4	Art Pamor	7	0	1	3	11
5	Art pamor (shkolla artistike)	30	7	5	3	45
6	Balet (shkolla artistike)	1	1	0	1	3
7	Biologji	267	153	198	63	681
8	Edukim Fizik	258	68	145	101	572
9	Fizikë	92	33	32	34	191
10	Gjeografi	374	137	183	91	785
11	Gjuhë Angleze	392	230	254	106	982
12	Gjuhë Frënge	75	21	38	18	152



13	Gjuhë Gjermane	26	1	12	9	48
14	Gjuhë Greke	0	6	0	0	6
15	Gjuhë Italiane	67	40	34	18	159
16	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	725	424	508	148	1805
17	Histori	366	164	257	65	852
18	Kimi	147	51	53	15	266
19	Matematikë	316	167	228	55	766
20	Muzikë	28	2	9	4	43
21	Muzikë (shkolla artistike)	52	21	25	10	108
22	Shkenca Sociale	115	14	93	9	231
23	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	16	26	15	8	65
<b>Total</b>		<b>4216</b>	<b>2281</b>	<b>2889</b>	<b>1008</b>	<b>10394</b>

Tabela e mëposhtme paraqet vendet vakante dhe provizore të shpallura nga zyrat vendore sipas 4 DRAP-ve.

Nr.	Profilet	DRAP Durrës	DRAP Fier	DRAP Korçë	DRAP Lezhë	Vendeve vakante/provizore
1	Arsimi Fillor	250	22	93	126	491
2	Arsimi Parashkollor	0	0	0	4	4
3	Arsimi Special	326	62	87	78	553
4	Art Pamor	25	8	4	5	42
5	Art pamor (shkolla artistike)	0	0	1	0	1
6	Balet (shkolla artistike)	0	1	0	0	1
7	Biologji	33	6	12	7	58
8	Edukim Fizik	76	52	39	48	215
9	Fizikë	41	1	9	7	58
10	Gjeografi	7	1	3	3	14
11	Gjuhë Angleze	144	22	85	60	311
12	Gjuhë Frënge	23	2	13	2	40
13	Gjuhë Gjermane	10	0	0	0	10
14	Gjuhë Greke	0	3	0	0	3

15	Gjuhë Italiane	22	2	7	4	35
16	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	32	6	15	18	71
17	Histori	16	4	7	4	31
18	Kimi	4	0	3	2	9
19	Matematikë	78	16	23	59	176
20	Muzikë	14	7	9	28	58
21	Muzikë (shkolla artistike)	7	11	7	0	25
22	Shkenca Sociale	18	4	5	2	29
23	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	55	6	7	11	79
24	Turqisht	2	0	0	0	2
	<b>Total</b>	<b>1183</b>	<b>236</b>	<b>429</b>	<b>468</b>	<b>2316</b>

### **C.5 Monitorimi i procedurave të Oficerëve të Sigurisë:**

Në bazë të Vendimit nr. 600, datë 9.10.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, në institucionet arsimore publike, ofrojnë shërbimin 150 oficerë sigurie. Shpërndarja e Oficerëve të sigurisë në institucionet arsimore, në nivel DRAP është si më poshtë:

Nr.	DRAP	Numri i Oficerëve të Sigurisë
1	Durrës	61
2	Fier	23
3	Korçë	42
4	Lezhë	24
	<b>Totali</b>	<b>150</b>

Në zbatim të shkresës së MASR, nr.1595 prot, datë 17.03.2021 “Për procedurat e emërimit të oficerëve të sigurisë”, pika 3, DPAP ka vijuar procedurat për plotësimin e vendeve vakante pas kryerjes së procedurave nga Drejtoritë Rajonale, duke njoftuar kandidatët e certifikuar, por të papunësuar të të gjitha ZVAP-eve (ish DAR/ZA), sipas listës dhe renditjes, të dërguar nga MASR.

Në zbatim të VKM-së nr. 553, datë 29.7.2022 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 600, datë 9.10.2018, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar

dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, të ndryshuar, pika 1/b “Miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucionet e arsimit parauniversitar të mesëm të lartë që kanë të paktën 100 nxënës dhe institucionet e arsimit parauniversitar bazë, që kanë të paktën 700 nxënës”, për vitin shkollor 2022-2023 do të ketë shtim të numrit të oficerëve të sigurisë në institucionet arsimore.

**C.6 Të dhëna mbi shkollat me klasa kolektive dhe mundësinë e përqendrimit të tyre:**

Klasat kolektive, apo të bashkuara janë klasat në të cilat mësojnë nxënësit e dy apo më shumë klasave të arsimit fillor ose të arsimit të mesëm të ulët. Klasat kolektive ndodhen kryesisht në zona të thella malore por jo vetëm në to, edhe në ato raste kur numri i nxënësve në klasë është më i vogël se numri i nxënësve që duhet të ketë klasa sipas Udhëzimit të MASR-së nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, të ndryshuar.

Nga identifikimi i shkollave me klasa kolektive dhe nga raportimi i 52 ZVAP-ve mbi numrin e nxënësve që mësojnë në klasa kolektive, në muajin shkurt 2022, rezultojnë 20325 nxënës. Nëse do t’i referohemi numrit total të nxënësve të arsimit bazë për vitin shkollor 2021-2022, në arsimin publik rezultojnë 8.5 % e nxënësve që mësojnë në klasa kolektive.

*Tabelë me të dhëna përmbledhëse për numrin e nxënësve në klasa kolektive, sipas klasave në DRAP-e:*

DRAP	Nxënës	Numri i nxënësve sipas klasave								
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Durrës	4103	583	596	611	582	441	386	312	314	278
Fier	3495	423	443	420	479	461	348	319	304	298
Korçë	8109	1005	1044	1085	1105	1004	773	765	656	672
Lezhë	4618	530	565	607	623	590	398	485	429	391
<b>Totali</b>	<b>20325</b>	<b>2541</b>	<b>2648</b>	<b>2723</b>	<b>2789</b>	<b>2496</b>	<b>1905</b>	<b>1881</b>	<b>1703</b>	<b>1639</b>

**Parashikim për përqendrimin e shkollave:**

Një nga objektivat e qeverisë ndër vite ka qenë dhe është ulja e numrit të shkollave dhe nxënësve që mësojnë në klasa kolektive. Në këtë kuadër si çdo vit edhe këtë vit është bërë një studim mbi mundësinë e përqendrimit të shkollave me klasa kolektive. Nga rakordimi me Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar për përqendrimin e shkollave me klasa kolektive për vitin shkollor 2022-2023, në muajin korrik, për këtë vit shkollor do të përqendrohen 40 shkolla (39 vartëse dhe 1 qendër) ku mësojnë 375 nxënës, nga të cilët 316 janë në klasa kolektive.

### III. Veprimtari monitoruese dhe vlerësuese.

DPAP ka zhvilluar veprimtarinë e saj, duke zbatuar planin vjetor mbështetur në prioritetet e MAS me veprimtari, të tilla si:

- Vlerësimi i shkollës për cilësinë e shërbimit të ofruar në fushën: “Drejtimi dhe menazhimi”;
- Vlerësimi i veprimtarisë së institucioneve të arsimit parauniversitar publik (procedurat e emërimit të mësuesve, formimi i klasave dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore);
- Vlerësimi e zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare private dhe funksionimit të tyre, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
- Monitorimi i drejtuesve didaktikë në institucionet arsimore parauniversitare private;
- Vlerësimi i ZVAP për procedurat e ndjekura për kualifikimin e mësuesve;
- Vlerësimin e veprimtarisë së ZVAP për procedurat e emërimit të mësuesve;
- Këshillimi i drejtuesve dhe punonjësve të institucioneve arsimore e të njëjësive arsimore vendore;
- Monitorimi i IAP AMU dhe AML publike dhe private për marrjen e masave për MSH dhe PKAB.
- Informimi i MAS, DRAP, ZVAP dhe institucioneve arsimore për gjetjet e monitorimeve dhe vlerësimeve të institucioneve arsimore;
- Vlerësimi i DRAP-ve për procedurën e ndjekur për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve në Portalin Mësues për Shqipërinë 2022.
- Inspektime bazuar në ankesa;
- Trajtim ankesash, etj.

Nga DPAP gjatë periudhës janar-gusht 2022 janë kryer 184 monitorime/vlerësime. Janë trajtuar dhe kthyer përgjigje ankesave që kanë ardhur në rrugë elektronike dhe me postë pranë institucionit.

### **Gjendja e infrastrukturës në institucionet e arsimit parauniversitar dhe masat e marra për fillimin e vitit shkollor 2022-2023.**

DPAP në mbështetje të ligjit 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 23 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, për të siguruar fillimin normal të vitit të ri shkollor 2022-2023 nëpërmjet zyrave vendore të arsimit parauniversitar, ka kërkuar verifikimin e infrastrukturës së godinave të arsimit parauniversitar. ZVAP-të brenda muajit qershor 2022, kanë dërguar pranë njëjësive të vetëqeverisjes vendore relacionet përkatëse mbi problematikat dhe mangësitë e konstatuara, në përfundim të vitit

mësimor 2021-2022, në lidhje me gjendjen infrastrukturore të godinave në institucioneve arsimore. DPAP me shkresën zyrtare nr.1467 prot., datë 12.07.2022 u është drejtuar të gjitha bashkive për marrjen e masave në lidhje me problemet e paraqitura.

Në nivel kombëtar zhvillohet mësim në 2035 godinave të shpërndara në gjithë territorin e vendit, si shkolla qendër apo vartëse. Janë 1178 shkolla qendër të arsimit bazë (AF dhe AMU) dhe të arsimit të mesëm të lartë (AML). Në gjithë territorin 875 shkolla vartëse hapin dyer për nxënësit edhe këtë vit mësimor.

Nga informacioni i paraqitur nga ZVAP-të në fundin e muajit Gusht 2022, rezulton se shumica e problemeve me infrastrukturën janë zgjidhur ose janë në proces.

Në lidhje me regjistrimin e nxënësve në shkolla gjatë periudhës qershor-gusht është ndjekur në vijimësi procesi i cili është shoqëruar me problematika për shkak edhe të aksesit jo të mirë që prindërit kanë pasur apo për neglizhencën e treguar nga vetë ata. Këtë vit ndryshe nga viti i kaluar procedura e regjistrimit u zhvillua e gjitha online sipas konfigurimeve përkatëse në e-Albania.

#### **IV. Kurrikula dhe zhvillimi profesional**

##### **Vlerësimi dhe monitorimi i shërbimit psiko-social gjatë vitit shkollor 2020-2021, 2021-2022**

Në kuadër të përmirësimit të dokumentacionit të nevojshëm për shërbimin psiko-social shkollor, grupi i punës i ngritur në bashkëpunim me ASCAP, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit psiko-social të ofruar në institucionet arsimore ka hartuar dy dokumentet bazë për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar.

- Dokumenti “Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psikosocial Shkollor” është zhvilluar brenda kontekstit të çështjeve aktuale të rëndësishme për arsimin dhe aspekteve të rëndësishme psikosociale, duke marrë parasysh objektivat strategjike të edukimit, me vështrim vizionar në zhvillimet e ardhshme në fushën e shëndetit mendor, në nivel kombëtar dhe lokal.
- Dokumenti “Parimet për Etikën Profesionale të Shërbimit Psikosocial Shkollor” është zhvilluar brenda kontekstit të çështjeve aktuale të rëndësishme për arsimin dhe aspekteve të rëndësishme psikosociale, duke marrë parasysh objektivat strategjike të edukimit, me një vështrim vizionar në zhvillimet e ardhshme në fushën e shëndetit mendor, në nivel kombëtar dhe lokal.

- Unifikimi dhe standardizimi i dokumentacionit të punonjësve të shërbimit psikosocial është i nevojshëm për ecurinë dhe funksionimin e këtij shërbimi.

Gjatë muajit korrik-gusht, në vijim edhe të ndryshimeve në Urdhrin 313 “Për shërbimin psikosocial”, janë evidentuar nevojat për shtimin e numrit të punonjësve të SHPS. Aktualisht janë shpallur 235 vende të reja në të gjitha zyrat arsimore duke synuar që numri i përgjithshëm i punonjësve të shërbimit psikosocial në shkolla të arrijë në 850.

### **Kualifikimi i mësuesve**

Në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 4, datë 26.02.2021, “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”, u zhvilluan procedurat për organizimin e kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar, për vitin shkollor 2021-2022, për të përfituar kategoritë përkatëse. Për vitin shkollor 2021-2022, morën pjesë në testim 2614 mësues.

### **Matura shtetërore 2022, sesioni i parë.**

Në zbatim të Urdhrit nr. 108 datë 04.03.2022 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të MAS, nr.1, datë 19.01.2022 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2022”, u organizuan dhe u monitorua në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë provimet e Maturës Shtetërore 2022, në datat:

1. **09.06.2022** – provimi i Gjuhës së Huaj (D3)
2. **11.06.2022** – provimi i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë (D1)
3. **17.06.2022** – provimi i Matematikës (D2)
4. **24.06.2022** – provimi i lëndës me zgjedhje

Provimet u zhvilluan në 167 qendra provimi, dhe pjesëmarrja në provim ishte mesatarisht 94% e maturantëve të regjistruar.

### **Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë (PKAB)**

Në zbatim të Udhëzimit Nr.6, datë 04.04.2022 “Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë, viti shkollor 2021-2022”, Sesioni i parë dhe Urdhrit Nr. 72,

datë 25.02.2020 “Për miratimin e Rregullores për zhvillimin e Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë në Republikën e Shqipërisë”, në datat e mëposhtme:

1. 20.06.2022 - provimi i Gjuhës shqipe;
2. 21.06.2022 - provimi i Gjuhës amtare;
3. 23.06.2022 - provimi i Matematikës;
4. 29.06.2022 - Provimi Gjuhës së Huaj,

Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar në varësi të tyre monitoruan zbatimin e Rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë 2022 për planifikimin, organizimin dhe realizimin e gjithë procesit të provimit, duke filluar që nga përcaktimi i qendrave të provimit, trajnimi i administratorëve, monitorimi i gjithë procesit të provimit si dhe analiza e plotë e ecurisë së tyre.

Provimi i arsimit bazë zhvillohet vetëm me shkrim. Rezultatet e provimeve të kombëtare të arsimit bazë, si një vlerësim i jashtëm i standardizuar, japin të dhënat e nevojshme për të monitoruar sistemin arsimor dhe nivelin e arritjeve të nxënësve, të cilat u shërbejnë mësuesve, specialistëve të arsimit, nxënësve dhe të gjithë të interesuarve në funksion të përmirësimit në arritjen e standardeve të mësimdhënies dhe të të nxënësve në shkollë.

Ato shërbejnë për të certifikuar nxënësit, që përfundojnë këtë cikël arsimor, pasi masin njohuritë dhe kompetencat e tyre në fushën e Gjuhës shqipe, Gjuhës amtare, Gjuhës së huaj e Matematikës duke dhënë informacion në lidhje me arritjet e nxënësve në kompetenca të caktuara të çdo fushë.

### **Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në Arsimin Fillor (VANAF)**

Në zbatim të Urdhrit Nr.78, datë 27.02.2020 “Për miratimin e rregullores për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor” si dhe Udhëzimit Nr.8, datë 21.04.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “ Për zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, viti shkollor 2021-2022”, më datë 23.05.2022 u zhvillua provimi i VANAF me nxënësit e klasave të pesta.

Testimi u zhvillua në 545 qendra, ku morën pjesë **29 599** nxënës nga **30 601** nxënës ose 97 % e tyre. Nga 377 nxënës me AK në klasa të pesta, 284 prej tyre ose 75% morën pjesë në provim.

### **Ditët e informimit të maturantëve 2022**

Në vijim të shkresës zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Nr.341 prot., datë 19.01.2022, “Për njohjen dhe informimin e nxënësve maturantë me institucionet e arsimit të lartë dhe

Adresa: Rruga “Aleksandër Moisiu”

Përballë IKV, Tiranë

website: [www.arsimiparauniversitar.gov.al](http://www.arsimiparauniversitar.gov.al)

programet e studimit që ato ofrojnë” dhe shkresës nr.125 prot., datë 03.02.2022, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar “Për njohjen dhe informimin e nxënësve maurantë me institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit që ato ofrojnë”, në kuadër të përgatitjeve për vitin akademik 2022-2023, u planifikua që, nga datat 22 shkurt deri më 31 Mars 2022, të organizohej nisma “Ditët e informimit të maurantëve 2022”, me qëllim që institucionet e arsimit të lartë të mundësonin promovimin dhe njohjen e nxënësve maurantë me programet e tyre të studimit, që do të ofrohen në vitin akademik 2022-2023.

Sipas informacioneve të DRAP-ve, procesi ka vijuar si më poshtë:

- IAL-të kanë plotësuar kalendarin dhe ua kanë dërguar Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar.
- ZVAP-et, kanë hartuar një kalendar, duke bërë shpërndarjen sipas institucioneve të arsimit të mesëm të lartë nën juridiksionin e tyre.
- ZVAP kanë shpërndarë kalendarin me datat përkatëse të takimeve online nga IAL-të, në IA nën juridiksionin e tyre.

### **Bashkëpunimi i IAL-ve me panairin “work and study”**

Mbështetur në shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, nr. 6809/1 prot., datë 10.02.2022, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, nëpërmjet panairit të lëvizshëm “Work & Study”, organizoi ditët e informimit të maurantëve për profilet e universiteteve në ZVAP: Kukës, Dibër, Shkodër, Lezhë, Berat, Fier, Gjirokastrë, Vlorë, Durrës, Korçë, Elbasan, dhe Tiranë. IAL-të, të cilat kanë bashkëpunuar me panairin e lëvizshëm “Eork and Study.

### **Provimi i shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit, sesioni XVI**

Në zbatim të shkresës nr. 1451 prot., datë 03.03.2022, për zhvillimin e provimit të shtetit "Për profesionin e rregulluar të mësuesit" sezoni XVII, në bashkëpunim me DRAP dhe ZVAP u morën të gjitha masat për regjistrimin e kandidatëve të cilët:

- a) kishin kryer me sukses praktikën profesionale;
- b) kishin rezultuar jo të suksesshëm në sezonet e kaluara;
- c) nuk ishin paraqitur në sezonet e mëparshme;
- d) ishin në marrëdhënie pune dhe kishin përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në edukim.

Për të marrë pjesë në provimin e shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit për sesionin XVII, u regjistruan gjithsej 3781 kandidatë të ndarë sipas profileve përkatëse.



### Nisma “Bëjmë detyrat e shtëpisë”

Një program i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit që synon të ndihmojë dhe aftësojë fëmijët në përparimin në dije dhe mundëson që nxënësi të kryejë detyrat e shtëpisë brenda mjediseve të shkollës, kjo për t’i ardhur në ndihmë nxënësve, të cilët nuk mund t’i përfundojnë detyrat në shtëpi. Gjithashtu ka si qëllim të mbështesë aftësitë shoqërore, fizike dhe intelektuale të nxënësve përmes pjesëmarrjes së tyre në aktivitete të organizuara pas përfundimit të procesit mësimor.

Në zbatim të Urdhrit nr. 811, datë 14.12.2018, “ Për miratimin e udhëzuesit për zbatimin e nismës “ Bëjmë detyrat e shtëpisë ”, si dhe shkresës së MASR me nr. 4512/2 prot., datë 27.09.2021 “ Mbi miratimin e përfshirjes së shkollave të reja në programin “ Bëjmë detyrat e shtëpisë”, për vitin shkollor 2021-2022, nisma u zbatua në 130 institucione arsimore, që janë nën juridiksionin e 25 ZVAP. U formuan 347 klasa mësimore, në të cilat janë përfshirë 7576 nxënës dhe 801 mësues.

#### ➤ *Zgjerimi i nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë”*

DPAP në bashkëpunim me DRAP dhe ZVAP-et identifikuan institucionet arsimore që mund të zbatonin programin BDSH, duke synuar shtimin e numrit të nxënësve nga institucionet e afërta arsimore në një distancë jo më shumë se 2 kilometra.

Nga informacioni i mbledhur rezulton se, 16 institucione arsimore të cilat i përkasin DRAP Korçë dhe DRAP Lezhë kanë të mundur zgjerimin e kësaj nisme duke ofruar këtë shërbim për 942 nxënës të tjerë.

#### ➤ *Vështirësi në zgjerimin e zbatimit të nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë”:*

- Prindërit nuk shfaqin interes në zbatimin e saj.
- Mungesa e transportit pasi shkollat kanë një distancë të konsiderueshme ndërmjet njëra-tjetrës.
- Institucionet arsimore janë pritëse
- Pandemia e shfaqur në vendin tonë.

#### ➤ *Ndikimet pozitive të zbatimi i nismës “Bëjmë detyrat në shkollë” në institucionet e arsimit parauniversitar:*

- Nxitjen dhe zhvillimin e interesave dhe prirjeve të nxënësve në fusha të caktuara përmes aktiviteteve jashtë kurrikulare që organizon shkolla.
- Përmirësimin e klimës dhe zhvillimin e frymës së bashkëpunimit në shkollë.

- Mbështetjen e familjeve dhe zhvillimin e partneritetit me prindërit e anëtarë të tjerë të komunitetit, për t’iu përgjigjur sa më mirë përbushjes së nevojave fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve si dhe për të garantuar zhvillimin e tyre të shëndetshëm.
- Sigurimin e kushteve dhe mundësive të barabarta për nxënie për të gjithë nxënësit dhe krijimin e mjedisi gjithëpërfshirës që mbështet dhe nxit progresin e çdo fëmije.
- Hapësirë pasdite për të kryer detyrat e shtëpisë dhe për të bërë mësimet në shkollë.
- Përfshirjen e fëmijëve AK, Roma dhe Egjiptian në program.

Për vitin 2022-2023 synohet që nismës t’i bashkohen shumë shkolla të tjera, të cilat do të vlerësohen nëse plotësojnë kushtet dhe kanë mundësi për të ofruar këtë shërbim.

DPAP ka mbledhur nga zyrat arsimore informacion në lidhje me ecurinë e projektit, “Bëjmë detyrat e shtëpisë në shkollë”. Të dhëna të detajuara paraqiten në tabelën e mëposhtme Nga disa zyra vendore janë paraqitur edhe kërkesa paraprake për përfshirjen e shkollave të tjera në këtë projekt. Aktualisht janë 140 të planifikuara për t’u shtuar.

<b>Bëjmë detyrat e shtëpisë</b>					
<b>DRAP</b>	<b><i>Fakti Qershor 2022</i></b>	<b><i>Kërkesa për shtesë</i></b>	<b><i>Klasa të formuara</i></b>	<b><i>Nxënës që ndjekin Projektin</i></b>	<b><i>Mësues të angazhuar</i></b>
Durrës	33	57	102	1914	139
Fier	25	24	65	1345	147
Korçë	22	30	63	1569	184
Lezhë	70	29	166	2895	336
<b>Gjithsej</b>	<b>150</b>	<b>140</b>	<b>396</b>	<b>7723</b>	<b>806</b>

**Për hapjen dhe funksionimin e shkollave qendër komunitare.**

Mbështetur në “Standardet për shkollën Qendër Komunitare Nr.1794 Prot., datë 13.03.2014 dhe kriterëve të përzgjedhjes, shkresa 1794/1, datë 31.03.2014, të gjithë ZVAP-të monitorojnë dhe verifikojnë plotësimin e kriterëve për përzgjedhjen e SHQK.

Në shtator 2021, listës zyrtare me 266 institucione arsimore të arsimit parauniversitar SHQK, iu shtuan edhe 195 institucione arsimore të arsimit parauniversitar. Tashmë janë 461 shkolla që planifikojnë dhe zhvillojnë gjatë një viti mësimor veprimtari të ndryshme, që nxisin procesin e shndërrimit të këtyre institucioneve në qendra komunitare.

DRAP	SHQK 2014-2021	SHQK 2021-2022	Total SHQK
Durrës	68	45	113
Korçë	75	61	136
Lezhë	66	55	121
Fier	57	34	91
<b>Gjithsej</b>	<b>266</b>	<b>195</b>	<b>461</b>

Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve dhe unifikimit të dokumentacionit për SHQK, janë zhvilluar takime këshilluese për këtë proces.

Tashmë të gjithë shkollat si qendër komunitare do të kenë të unifikuar në strukturë:

- Planin e punës për veprimtaritë e SHQK-së.
- Statistika të tilla si klubet jashtëshkollore dhe llojet e tyre, përfitues, veprimtari projekte që mbështeten nga donator.
- Raportimin 3 mujor dhe vjetor.

Për vitin 2022-2023 pranë DPAP kanë aplikuar edhe 94 shkolla të tjera të cilat do të vlerësohen nëse i plotësojnë standardet për t'u bërë pjesë e projektit. Tabela më poshtë paraqet të dhëna në nivel DRAP-je për numrin aktual të shkollave që e zbatojnë nismën dhe nevojave që paraqesin për zgjerimin e tyre. Vihet re se nga numri i miratuar 14 shkolla nuk e zbatojnë këtë nismë për shkak edhe të problematikave me infrastrukturën apo me mësimin me turne. Për vitin që vjen nga zyrat vendore, janë kërkuar të bëhen pjesë e këtij projekti edhe 160 shkolla të tjera.

<b>Shkolla qendër komunitare</b>		
DRAP	Fakti qershor 2022	Kërkesa për shtesë
Durrës	114	71

Fier	90	22
Korçë	124	38
Lezhë	119	29
<b>Gjithsej</b>	<b>447</b>	<b>160</b>

### **Kurrikula e Kodimit:**

Në kuadër të zbatimit të projektit *elementIT*, zbatimit të kurrikulës së kodimit në klasë të parë, gjatë periudhës shkurt –mars 2022 është mbledhur informacion për shkollat të cilat do të ishin pjesë e këtij projekti i cili do të zbatohet fillimisht në 100 shkolla.

Pjesë e këtij projekti janë shkollat që plotësonin kriteret e mëposhtme:

- Infrastrukturë shumë të mirë (energji elektrike, klasa të pajisura me tavolina dhe karrige në gjendje të mirë, ngrohje, dyer të sigurta, lidhje interneti)
- Të kenë të paktën 3 klasa paralele: të para, të dyta dhe të treta
- Të kenë minimumi 1 mësues TIK-u të dedikuar për shkollë
- Mundësisht të ketë kabineti informatike në gjendje të mirë

Në muajin korrik 2022, në kuadër të zgjerimit dhe të shtrirjes më gjerë të projektit, janë përzgjedhur 200 shkolla të tjera të cilat do të jenë pjesë e projektit të kodimit.

### **Fëmijët e rikthyer nga zonat e konfliktit**

Në zbatim të Udhëzimit nr.10, datë 10.05.2021 për “Regjistrimin dhe mbështetjen në institucionet arsimore parauniversitare publike të fëmijëve të personave në situatë migrimi/azili, refugjatë, të fëmijëve të huaj të pashoqëruar, të fëmijëve që kthehen nga emigracioni, nga zonat e konfliktit apo fëmijë, viktimat të trafikimit, në Republikën e Shqipërisë.”

Gjatë gjithë periudhës shtator 2021–prill 2022 është kryer regjistrimi në shkollë i të gjithë fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit. Qëllimi kryesor ka qenë të lehtësohet procesi i integritit dhe të rriten aftësitë sociale.

Pas regjistrimit, për secilin nxënës është kryer testimi i njohurive në të gjitha lëndët, si dhe aftësitë në të folur dhe të shkruar, në mënyrë që të lehtësohet puna me këta fëmijë.

Drejtoritë e shkollave kanë raportuar për problematika të integritit dhe ecurinë e këtyre fëmijëve në mënyrë periodike, gjithashtu me mbështetjen dhe koordinimin e CVE janë zhvilluar

sesione informuese me mësuesit e shkollave ku këta fëmijë janë riintegruar. Rezultatet janë pasqyruar edhe në arritjet e deritanishme të këtyre nxënësve.

### **Strategjia e Edukimit Ligjor Publik (SELP) 2019-2023**

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Edukimit Ligjor Publik (SELP) 2019-2023, në të gjitha institucionet arsimore janë zhvilluar veprimtari ndërjegjësuese nga Njësia e Shërbimit Psikosocial (NjShP) në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave, për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, për mbrojtjen nga diskriminimi dhe për barazinë gjinore, duke bashkëpunuar me aktorë të shoqërisë civile dhe në veprimtaritë e rrjeteve profesionale të mësuesve. Në këtë kuadër janë zhvilluar aktivitete të shumta, si:

- Trajnime me mësues me temë “Njohja Institucionale me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe njohjen e detyrimeve Institucionale” nga punonjësit e SHPS.
- Takime të organizuara nga psikologu/punonjësi social i shkollës me Punonjës të Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve për ndërjegjësimin e tyre në lidhje me raportimin e dhunës tek ata dhe bashkëmoshatarët e tyre.
- Shkollat i kanë kushtuar rëndësi aktiviteteve festive të Ditës së Fëmijëve, ku një rëndësi e veçantë i është kushtuar promovimit të të drejtave të tyre në forma rekreative dhe artistike.
- Trajnim me mësuesit e lëndës së Qytetarisë, të cilët kanë një qasje më të afërt me problematikat në shkolla dhe trajtojnë në lëndën e tyre tema të dedikuara për çështjet sociale.
- Aktivitetet kundër ekstremizmit dhe bullizmin. Çdo shkollë ka hartuar prej dy vitesh këto dokumente, të cilat çdo vit rishikohen nga grupet e punës. Ky element është monitoruar nga psikologët/punonjësit social në shkolla.
- Biseda për ndërjegjësimin e nxënësve për të ruajtur infomacionin personal dhe për të treguar kujdes me marrëdhëniet online. Mësuesit e qytetarisë kanë dhënë informacion lidhur me Ligjin për Mbrojtjen e e të Dhënave Personale dhe për Institucionin e Komisionerit për mbrotjen nga Diskriminimin.
- Trajnime lidhur me stereotipat, diskriminimin dhe paragjykimin gjinor. Rritja e aftësive të mësuesve për trajtimim me shumë kujdes dhe prioritet të këtyre koncepteve me nxënësit.
- Psikologët dhe punonjësit social në shkolla kanë zhvilluar fushatë takimesh me nxënës, ku i kanë njohur ata me Ligjin për Masat kundër Dhunës në Marrëdhëniet Familjare.
- Në kuadër të Fushatës Portokalli shkollat kanë zhvilluar aktivitete ku kanë promovuar të drejtat e grave dhe vajzave dhe të cilat janë publikuar në rrjetet sociale.

Gjatë aktiviteteve janë zhvilluar lexime, dramatizime, ndjekje të filmave apo videove.

### Regjistrimi i fëmijëve ukrainas

Në zbatim të urdhrin nr.185, datë 06.04.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për arsimimin e përkohshëm dhe mbështetjen psikosociale të fëmijëve të ardhur për shkak të luftës nga Republika e Ukrainës.” dhe referuar informacionit të marrë nga Ambasada e Republikës së Ukrainës në Shqipëri, për fëmijë të moshës 3-17 vjeç janë marrë të gjitha masat për t’u siguruar shërbim arsimor.

## V. Bashkëpunime institucionale

Gjatë vitit 2022 DPAP-ja ka bashkëpunuar me institucionet MAS, DRAP dhe ZVAP duke u angazhuar maksimalisht me propozime konkrete për ndryshimin e bazës ligjore në fuqi duke u mbështetur në problematikat dhe vështirësitë e hasura gjatë zbatimit në praktikë të tyre. Më poshtë paraqesim shkurtimisht disa nga ndryshimet e propozuara;

- Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë.
- Propozuar për ndryshim Udhëzimi nr.12, datë 10.06.2021 “Për pranimin dhe emërimin në një vend të mirë pune të mësuesit në institucionet arsimore parauniversitare nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”. Qëllimi i këtyre propozimeve lidhet me rritjen e efektivitetit dhe zbatimit të procesit të pranimit/emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune. Nëpërmjet propozimeve është synuar të:  
Ndryshohet përgjegjësia për procedurat e konkurrimit dhe të pranimit të mësuesit në një vend të lirë punë.  
Të qartësohet përgjegjësia dhe kompetencat ndërmjet institucionit epror dhe atij vartës.  
Shpallja e vendit të lirë të punës të bëhet mbi bazën e ndarjes së nivelit të diplomës.  
Përcaktimi i të drejtave të drejtorit të institucionit arsimor parauniversitar mbi shkeljet e profesionit të mësuesit.
- Udhëzimin Nr.2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”.
- Vlerësimin e kartës së performancës së shkollës,
- Standardet profesionale të vlerësuesit të institucioneve të arsimit parauniversitar,
- Urdhrit nr.313, datë 20.10.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social.

- Për disa ndryshime në urdhrin nr.234, datë 19.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar”
- Draft rregulloren e Maturës Shtetërore dhe Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë.
- Amzën digjitale apo mënyrën e regjistrimit të nxënësve në klasën e parë dhe të dhjetë të arsimit parauniversitar.
- Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.
- Për disa ndryshime në VKM-në nr. 682, datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar.
- Kërkesë për ndryshimin e Urdhrit nr.454, datë 13.09.2019 “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirim nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizmit të saj”.
- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, kanë nënshkruar një “Marrëveshje Bashkëpunimi”. Bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta gjatë gjithë vitit shkollor, për një orientim më të mirë të nxënësve të institucioneve të arsimit të mesëm të ulët drejt Arsimit Profesional si dhe në përgjigje të kërkesave të punësimit për t’i garantuar dhe ofruar tregut, individ të arsimuar nga shkolla profesionale të cilët do të jenë profesionist në fusha përkatëse duke rritur efikasitetin dhe efektivitetin e punësimeve, parë kjo në aspekt afatgjatë.
- Pjesë aktive në propozimet për ndryshime Ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar të Republikës së Shqipërisë”.

### **Analiza e shpërndarjes së mësuesve ndihmës në IAP-të publike.**

Mbështetur në udhëzimin e Ministrit të MASR, Nr.26 datë 25.11.2019 “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuar në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, nxënësit me aftësi të kufizuar që janë vlerësuar nga komisioni multidisiplinor dhe numri i mësuesve ndihmës, sipas rekomandimit që është dhënë në momentin e vlerësimit për vitin shkollor 2021-2022 janë si më poshtë.

<b>Mësuesit ndihmës</b>				
<b>DRAP</b>	<b>Fakti qershor 2022</b>	<b>Me arsim special</b>	<b>Të tjerë</b>	<b>Kërkesa për shtesë</b>
Durrës	497	42	455	106
Fier	453	59	394	23
Korçë	326	16	310	45

Lezhë	223	16	207	51
<b>Gjithsej</b>	<b>1499</b>	<b>133</b>	<b>1349</b>	<b>225</b>

### **Monitorimi i procedurave të konkursit për drejtues të IAP-ve publike**

Nga raportimet e Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar për procedurat e konkurrimit të drejtorëve të IAP-ve publike, rezulton se për periudhën Janar-Qershor 2022 janë planifikuar për t'u zhvilluar procedura kokurrimi sipas planit të miratuar.

Nga DPAP janë monitoruar shumica e procedurave në gjithë territorin si dhe janë trajtuar 13 raste të cilat janë ankimuar në organet eprore.

### **Procedura disiplinore**

Gjatë vitit 2022 janë zhvilluar 24 procedurat disiplinore për punonjësit në varësi të DPAP-së. Komisionet Ad-Hoc të ngritura për secilin rast kanë trajtuar të gjitha rastet dhe kanë dalë me vendime konkrete sipas përcaktimeve të Urdhrit nr.454, datë 13.09.2019 “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirimimin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”, i ndryshuar.

### **Monitorimi i institucioneve arsimore private**

Në mbështetje të Ligjit nr.69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr.99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar”, VKM nr. 159, datë 01.03.2017 “Për miratimin e standardeve të kopshtit”, Udhëzimit nr.15, datë 12.07.2013 “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licensë të institucioneve private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, i ndryshuar.

Gjatë muajit Maj 2022, është mbledhur informacion i detajuar mbi mbylljen e institucioneve arsimore private të cilat kanë rezultuar të palicensuar. Nga informacioni i gjeneruar është mbajtur një raport i detajuar mbi zyrat të cilave ju është kërkuar informacioni përkatës. Gjithashtu për mbylljen e këtyre subjekteve të palicensuar, është kërkuar bashkëpunim edhe nga institucione të tjera si: Bashkia, AKU, Drejtorja e Policisë Vendore, dhe Institucionin e Prefektit.



Me shkresën nr.871prot., datë 20.04.2022 të dërguar nga DPAP ju është kërkuar ZVAP-eve si:

1. ZVA Durrës,
2. ZVA Fier,
3. ZVA Kamëz,
4. ZVA Korçë-Pustec,
5. ZVA Krujë,
6. ZVA Lezhë,
7. ZVA Sarandë-Konispol-Delvinë,
8. ZVA Shkodër,
9. ZVA Tiranë,
10. ZVA Vlorë- Himarë,
11. ZVA Vorë,

të dërgojnë informacion të detajuar mbi masat e marra për njoftimi e organeve si AKU, Drejtorisë së Policisë së Qarkut, Drejtorisë së Tatimeve, Inspektoratit të Punës dhe Njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore për subjektet private që ushtrojnë veprimtarinë pa licensë në fushën e arsimit për të bërë të mundur mbylljen e aktiviteteve të tyre.

Me shkresa zyrtare zyrat arsimore kanë informuar institucioneve përkatëse për të bërë të mundur mbylljen e këtyre subjekteve të palicencuara si:

Edhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar i është drejtuar, Drejtorisë së Tatimeve, Drejtorisë së Policisë, Inspektorati Qendror, Autoriteti Kombëtar, Bashkive duke kërkuar bashkëpunim me të gjithë institucionet për të marrë të gjitha masat për mbylljen e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në fushën e arsimit pa licensë apo jo në përputhje me kushtet e kërkuara në licensim.

Në veprimtarinë e saj të përditshme dhe nga problematikat që hasen në zbatim, ka lindur nevoja për ndryshime të bazës nën ligjore në fuqi të cilat i listojmë më poshtë.

- Udhëzimi Nr.12 datë 10.06.2021 të MASR “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit. parauniversitar dhe për administrimin e Portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar.
- Udhëzimi Nr.30 datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve në klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
- Vendimi nr. 682, datë 29.7.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, i ndryshuar.

- Rregullore nr.4699/1 datë 30.04.2019 "Për rekrutimin e punonjësve në varësi të DPAP-së".
- Urdhri i Ministrit të MASR Nr. 31 datë 28.01.2020 "Për miratimin e Rregullores për funksionimin e Institucioneve të Arsimit Parauniversitar".
- Udhëzimi Nr.2 datë 28.01.2020, për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të IPAP, të ndryshuar"

Për periudhën Janar-Gusht 2022, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka zbatuar politikën menazheriale duke u fokusuar në nevojat e domosdoshme dhe duke u përqëndruar në përgjegjësitë funksionale të saj:

1. Ofrimin e një shërbimi cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.
2. Organizimin e punës për menazhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Koordinimin e administrimit të burimeve njerëzore në sistemin arsimor parauniversitar sipas legjisllacionit në fuqi, etj.